



PROCESVERBALI

Nga mbledhja e rregullt e Kuvendit Komunal të Rahovecit, e mbajtur më **29.01.2016 (e Premte)** me fillim në ora **10.15**. Mbledhjen e kryesoi kryesuesi i Kuvendit **Nahit Elshani**.

Kryesuesi Elshani – Fillimisht më lejoni të përshëndes Kryetarin e komunës z Idriz Vehapin, nënkryetarin z. Xhemali Haxhimustafa me bordin e drejtorëve, Drejtorin e Policisë të regjionit të Gjakovës Muhamet Hasi me bashkëpunëtorët, Komandantin e stacionit të policisë së Rahovecit Osman Ismaili me bashkëpunëtorë, përfaqësuesit e OSBE-së, monitoruesin e KDI-së, Monitoruesit e KFORIT, përfaqësuesit e mediave, një përshëndetje e veçantë shkon për nxënësit e shkollës së mesme Profesionale “Selajdin Mullabazi - Mici” të Rahovecit të cilët sot i kemi këtu prezent, juve delegat të nderuar dhe gjithë të pranishmit e tjerë. Besoj se rendin e ditës e keni mare me kohë, Nëse ka ndonjë prej delegatëve të nderuar që ta arsyetojë mungesën në mbledhjen e kaluar?

Rend Dite

1. Aprovimi i Procesverbalit nga mbledhja e kaluar,
2. Raporti vjetor i Punës për Vitin 2015 të Stacionit Policor Rahovec,
3. Shqyrtimi dhe aprovimi i Draft Planit të Veprimit për Transparencë në Komunën e Rahovecit,
4. Shqyrtimi dhe aprovimi i Draft Rregullores për transparencë,
5. Shqyrtimi dhe aprovimi i Draft Rregullores për dhënien e lejeve mjedisore komunale,
6. Rishqyrtimi i Vendimit të Kuvendit të Komunës së Rahovecit 01 Nr. 223/15 të datës 09.12.2015,
7. Shqyrtimi i Raportit për punët inspektuese për periudhën Janar – Dhjetor 2015,
8. Shqyrtimi i kërkesës së N:T:H “ Mowenpick” nga Rahoveci,
9. Shqyrtimi i kërkesës së Razije Kryeziu nga Rahoveci,
10. Pyetjet dhe përgjigjet në pyetjen e këshilltarëve.

Kryesuesi – Sot e kemi edhe një pikë shtesë të rendit të ditës a ajo është Raporti Vjetor i punës për vitin 2015 të Stacionit Policor në Rahovec. E qes në votim kush është që kjo pikë të jetë si pikë shtesë dhe në të njëjtën kohë të jetë edhe si pikë e 2 e rendit të ditës: Konstatohet se në mënyrë unanime është aprovuar që Raporti i Vjetor i punës për vitin 2015 të Stacionit Policor në Rahovec të jetë si pikë shtesë.

Rasim Fazliu – Përshëndetje për të gjithë të pranishmit në sallë, Mendoj se caktimi i mbajtjes së mbledhjes së kuvendit në ditën e sotme është një pakujdesi, sepse sot është një ditë e veçantë është dita e rrënies së dëshmorëve në Rugovë të Hasit dhe në këtë ditë kemi dëshmor të rënë edhe nga Komuna e Rahovecit. Besoj se nuk do të përsëritet më ky gabim, të gjithë e kemi për obligim ti nderojmë dëshmorët sepse ata janë dëshmor të Kombit. Në shenjë respekti ju kisha kërkuar që të mbajmë 1 minutë heshtje. 1 minutë heshtje është mbajtur në shenjë respekti për dëshmorët e rënë në Rugovë të Hasit dhe gjithë dëshmorëve tjerë.

Kryesuesi - Besoj se të gjithë kemi respekt për dëshmor dhe familje të dëshmorëve, mendoj se puna e kuvendit është punë e kuvendit dhe sot kemi të bëjmë me një ngjarje që ka të bëjë me Komunën e Gjakovës dhe nuk ka të bëjë me Komunën e Rahovecit. Po ashtu ne nuk e kemi kalendarin e ngjarjeve që i shënojnë komunat e tjera, kështu që mendoj se nuk ka kurrfarë të keqe pse është caktuar kjo seancë sot. Dëshmorët mundë të nderohen edhe me punën dhe aktivitetet e delegatëve të komunës sonë.

Bahtjar Hoti – Kryesuesi nuk është në rregull se si e dhatë ju përgjigjen për punën e dëshmorëve. Dëshmorëve duhet të i kushtohet rëndësi e posaçërisht dita e rrënjës së tyre, ata kanë rënë në fushë të nderit. Mendoj se nuk bëhet nderime duke mbajtur mbledhje të kuvendit por nderimi bëhet duke shkuar tek vendi i rrënjës.

Kryetari – Përshëndetje për të gjithë të pranishmit në sallë, Është mirë që mos me i dhanë ngjyra të ndryshme këtyre ngjarjeve, mendoj se të gjithë ne i respektojmë dëshmorët, disa i njohim edhe personalisht. Deri sa nuk janë ngjarjet në kalendarin e komunës sonë mundë të ketë edhe kësi lëshime dhe harresa, jam shumë i bindur se kjo nuk është bërë me qëllim. Kryesuesi po ju liron që të shkoni një grup që ti nderoni në emër të Kuvendit Komunal të Rahovecit dhe me kaq të mbyllet kjo temë.

Kryesuesi – Kalojmë në pikën e parë të rendit të ditës:

1. Aprovimi i Procesverbalit nga mbledhja e kaluar,

Kadri Dellova – Është mirë që të del një rekomandim sot nga kuvendi që komuna ta punësojë një lektor sepse shumë dokumente që dalin nga komuna dalin me gabime drejtshkrimore. Kam kërkuar që 2 vite që të bëhet punësimi i një lektori por tash mendoj se është koha.

Kryesuesi – E qes në aprovim Procesverbalin: Konstatoj se në mënyrë unanime është aprovuar procesverbali i mbledhjes së kaluar. Kalojmë në pikën e radhës:

2. Raporti vjetor i Punës për Vitin 2015 të Stacionit Policor Rahovec,

Osman Ismaili – Komandant i Stacionit Policor të Rahovecit – Komandanti Ismaili prezantoi raportin vjetor të punës për vitin 2015 të Stacionit Policor të Rahovecit para kuvendareve, Ismaili, po ashtu prezantoi të arriturat e këtij stacioni dhe sfidat që i ka pasur ky stacion policor për vitin 2015.

Fatmir Iska – Përshëndetje për të gjithë të pranishmit, Falënderoj komandantin e policisë të stacionit në Rahovec që prezantoi raportin e punës së stacionit policor si para një viti po ashtu edhe këtë vite. Më vije shumë mirë që ka rrënje të kriminalitetit në gjitha ato fusha që i prezantoi komandanti sot, shpresojmë se do bëhen kësi raportime edhe në vitet vijuese. Raportimi për dhunë në familje a është grua burrin apo buri gruan, e them pak me shaka.

Flori Boshnjaku – Përshëndetje për të gjithë të pranishmit, Falënderoj Komandantin për këtë raport, kisha kërkuar nga komandanti që në mënyrë elektronike të na dërgoj nga një kopje secili anëtar të kuvendit sepse këto të dhëna janë me rëndësi edhe për ne. Pyetja ime është tek stafi policor? Drejtori tha se kemi mungesë të stafit policor. Sa kërkesa i keni dërguar qendrës rajonale në Gjakovë apo qendrës në Prishtinë që të ju mundësojnë shtimin e këtij stafi. Po ashtu ceket edhe mungesë të Mallrat dhe Shërbimet si uniformat dhe disa sende të tjera me rëndësi për policin e Kosovës sepse ata janë figura e shtetit tonë dhe në planin e punës suaj a i keni paraparë që këto të shtohen. Diçka tjetër që më intereson mua është tek të hyrat e zakonshme që i ceku komandanti me i krahasu me vitin 2014 ka pas një rrënje shumë e madhe, dua ta di se pse ka kaq rrënje të të hyrave të zakonshme.

Rasim Fazliu – Falënderoj komandantin për informatat që na dha, më vije mirë që krimi ka pësuar rrënje, shpresoj se nuk do të ketë fare raste të krimit, po ashtu ka pasur rritje të zbulimit të i rasteve të vrasjeve. Pyetja ime është a ka ndonjë informatë ose a ka përparim në lidhje me vrasje që janë bërë deri më tani.

Selim Duraku – Më vije mirë që në shumicën e fushave ka rrënje të kriminalitetit. Kam një pyetje për komandantin? në muajin e fundit ka ndodhur një raste në shkollën e mesme të Krushës së Madhe “Ukshin Hoti” ku kanë marrë pjesë personat jo zyrtarë dhe si pasojë e krejt kë saj ka pësuar një nxënës i kësaj shkolle, pyetja ime është çka ka bërë policia në lidhje me këtë rast.

Hysni Gashi – Përshëndetje për të gjithë të pranishmit, falënderoj komandantin e policisë për raportim. Me erdh shumë mirë që ishin disa të dhëna inkurajuese. Pyetja ime: Sa e di unë para disa viteve ka qenë në projekt i Policisë së Kosovës, polici i lagjes ose polici i fshatit kështu diçka, më intereson se a është ende aktiv ky projekt ose plan dhe cilat janë detyrat e policit të lagjes ose fshatit në mënyrë që ne si banor të atyre fshatrave të dimë se si duhet të bashkëpunojmë me ta. Pyetja ime tjetër është a ka mundësi të shpeshohen patrullat në orët e vona nëpër fshatra sepse kohët e fundit janë duke ndodhur goxha vjedhje.

Sinan Ejupi – Përshëndetje për të gjithë të pranishmit, pyetja ime për Komandantin e Policisë është: si qëndron puna rreth zbulimit të rasteve, a jeni më efektiv në zbulimin e rasteve në krahasim me vitin e kaluar, respektivisht e keni ndonjë instrument matës.

Besnik Hoti – Përshëndetje për të gjithë, pyetja ime për Komandantin është: a ka ndonjë mundësi që në një të ardhme të afërt të vendoset një nën stacion i policisë në fshatin Ratkoc, ku të gjithë e dimë që pjesa nga Ratkoci e deri në Klinë është një pjesë jo shumë e sigurt.

Rukije Krasniqi – Përshëndetje për të gjithë të pranishmit, pyetja ime për Komandantin e policisë është: sa janë konfidenciale raportimet e rasteve të ndryshme nga qytetarët, sepse këtu u tha se po hezitohet shpesh herë të paraqiten rastet. Pyetja dytë është a janë duke u marrë masa për persona që janë duke i shkaktuar pyet në komunën tonë. Kam një falënderim për policinë e Rahovecit që janë duke bërë kontrollë të shpeshta në mbrëmje tek shkollat e mesme dhe fillore në Rahovec.

Afrim Limani – Përshëndetje për të gjithë të pranishmit në sallë, falënderoj komandantin e policisë për këtë raport të detajuar të saktë dhe me shumë të dhëna. Ajo që më la përshtypje qatë raportimit të komandantin është rritja e përqindjes së zbulimit të rasteve të reja, për këtë punë ju inkurajoj dhe kërkoj që në të ardhmen puna juaj të jetë edhe ma e madhe sepse kjo është një pikë e ndjeshme dhe pikërisht me këtë ritet edhe besimi i qytetarëve ndaj institucionit tuaj.

Beatrisa Demiri Pista – Përshëndetje për të gjithë të pranishmit, falënderoj komandantin për këtë raportim, sipas raportit që e dha komandanti shihet se për këtë vit jemi njëra nga komunat që ka pasur më së paku probleme, te ne ose ndodh diçka e madhe ose nuk ndodh asgjë. Mendoj se është shumë e nevojshme që shkollat që kanë numër të madh të nxënësve, po ashtu në hyrje dhe dalje të qytetit të instalohen kamerat e sigurisë, t' kishin qenë të instaluar kamerat vitin e kaluar nuk kish pas të paguar.

Osman Ismaili – Faleminderit për pyetjet e bëra dhe për gjitha ato fjalë t mira që u than për policinë e Kosovës nga ana e juan. Sa i përket dhunës në familje, dhunë në familje është kur prindi e rreh fëmijën, bashkëshorten, çdo dhunë fizike, psikike, rrahje, lëndime ose kufizim të lëvizjes të ndonjë anëtari të familjes paraqet dhunë në familje, pra të gjithë ata që jetojnë në një kulm. Kjo paraqet ose kundërvajtje ose vepër penale. Florije ky raporte nuk i shpërndahet kuvendarëve, por kush dëshiron të shfletoj mundet të merë një kopje për të shfletuar sepse ky raporte nuk debatohet. Florija e pati edhe një pyetje rreth kërkesave të dërguara DRP në Gjakovë, për fat të keq DRP në gjakove ka edhe më pak staf se sa unë që kam në Rahovec, pra drejtorja është formuar nga kudra që janë marrë nga Malisheva, Rahoveci dhe stacioni i Gjakovës. Kërkesat rreth pajisjeve logjistike dhe veturave ne i bëjmë çdo ditë por e gjitha varet prej mjeteve buxhetore si në nivel të MPB si në nivel të Policisë së Kosovës. Tek rrënja e mjeteve buxhetore që derdhen në buxhetin e komunës, problem i vetëm që ka rrënje është pezullimi i vendimit që është bërë nga MPB në fund të vitit të kaluar për mos konfiskim të dokumenteve. Rasimi pyeti rreth vrasjeve, në këtë vite ne kemi vetë një rast të vrasjes, vitin e kaluar kemi pasur 2 raste. Sa i përket vrasjes së ish kandidatit për deputet z Elvis Pista, njësitet janë duke punuar është bërë një punë e madhe dhe shumë voluminoze or ja se rezultat ende nuk kemi. Selimi pyeti për një rast në shkollën e mesme në Krushë të Madhe, atje ka ndodhur një rrahje në këtë rast është i ndjekur penalisht prindi që ka hyrë në shkollë edhe djali i tij është i përjashtuar nga shkolla, rasti ka shkuar në prokurori për lëndime të lehta. Hysni Gashi pyeti për projektin polic i lagjes, ky projekt vazhdon permanent dhe është ende aktiv, por problem të vetëm e kemi me lokacion atje ne jemi duke u munduar që ta gjejmë një zyrë në atë pjesë së paku 3 herë në javë të jenë policët në ato pjesë në mënyrë që të jenë ma afër problemeve të qytetarëve. Sinani pyeti për zbulimin e rasteve, në vitin e kaluar ka qenë 77% zbulueshmëria e rasteve ndërsa në këtë vite është 80%. Çka kalon mbi 50% të zbulueshmërisë së rasteve ne mendojmë se është bërë një punë e mirë. Besniku tha se Ratkoci është një zonë e nxehtë, është shumë e vërtet, Ratkoci nga Rahoveci është larg 20 km por Mrasori është edhe 20 km më larg, 2 vite mbas lufte në Ratkoc ka funksionuar dega e nënstacionit të policisë është ndërprerë për shkak të stafit dhe për shkak të shpenzimeve. Ne e kemi një shans që ta bëjmë në Ratkoc një zyrë, do të kërkojmë mbështetje edhe nga Kryetari i komunës po ashtu edhe nga aktivistë të fshatit dhe të caktohet një orare 2 ose 3 herë në javë në mënyrë që

qytetarët e asaj zone të raportojnë atje. Sa i përket një nën stacioni ne e kemi bërë shumë herë këtë projekt por MPB nuk e ka parë si prioritet dhe e ka hedhë poshtë këtë projekt. Rukije qytetari ka të drejtë të jetë anonim çdo herë gjatë raportimit të ndonjë rasti dhe ne maksimalisht duhet ta respektojmë. Sa i përket vjedhjes së pyjeve unë e ceka njërën prej dukurive, vetëm zhavorri i lumit Drin mundet të barazohet me këtë dëm çka është duke u bërë, ne më pyje nuk kemi kanë mbetur vetëm disa thupra. Kjo është e sanksionuar si vepër penale përmbi 2 m, ndërsa kundërvajtje është deri në 2 m. Kemi raste mjaftë që i kemi parashtruar si raste penale dhe prapë do të merremi me të por duhet edhe një angazhim nga ekonomia e pyjeve dhe një interesim më i madhe nga ana e tyre. Patrullimet rreth shkollave z Rukije ato janë permanente posaçërisht në intervalin mëngjes, mesditë dhe në mbrëmje ky patrullim nuk do të ndalet ne do të vazhdojmë më tutje njësoj. Z. Beatris ne jemi veç në kuadër të një projekti nga KLSP – ja, OSBE-ja do të investoj një sasi të mjetëve, po ashtu kemi një premtim edhe nga Kryetari i Komunës me stafin e tij për vendosjen e disa dhjetëra kamerave si nëpër shkolla po ashtu edhe në qytet në disa pika ku janë me rëndësi, shpresoj se ky projekt do të realizohet.

Kryesuesi – Falënderoj Komandantin për këtë raportim detal dhe për gjitha përgjigjet që i dha. Fjalën ja japë Drejtorit të Policisë për regjionin e Gjakovës z Muhamet Hasit.

Muhamet Hasi, Drejtor i stacionit për regjionin e Gjakovës – Drejtori Hasi përshëndeti të gjithë të pranishmit në sallë, drejtori Hasi tha i vije shumë mirë se komuna e Rahovecit është njëra ndër komunat më të mira dhe më të qeta po ashtu tha se në atë vend ku punohet nuk ka kohë për sende tjera. Gjithashtu potencoj se nuk do ti harrojmë ato krime që janë kryer më parë do punojmë çdo ditë për ti zbardhur ato krime. Po ashtu përshëndeti stacionin policor të Rahovecit që janë duke bërë një punë shumë të mirë.

3. Shqyrtimi dhe aprovimi i Draft Planit të Veprimit për Transparencë në Komunën e Rahovecit, Edhe kjo pikë e rendit të ditës është shqyrtuar dhe trajtuar në mbledhjen e KPF-së dhe si rekomandim ka dalë që kjo pikë ti kaloj kuvendit për aprovim dhe shqyrtim si dhe zyra ligjore të bëjë verifikimin dhe përshtatjen e termëve brenda rregullores.

Nënkryetari – Përshëndetje për të gjithë të pranishmit, kjo pikë e rendit të ditës është shqyrtuar edhe në KPF, sot do i preki pikat më të rëndësishme dhe më kryesore se si kemi ardhur deri tek ky draft plan dhe cilat janë referencat të cilat na kanë obliguar për një gjë të tillë. Draft plani i veprimit për transparencë ka ardhur si produkt i një kërkesë nga MAPL dërguar Kryetarit të Komunës, duke e sugjeruar dhe kërkuar nga Kryetari i komunës bazuar në ligjin për transparencë dhe qasje në dokumente publike, njëherit edhe udhëzimit administrativ Nr. 05/2013. Komunitat e Kosovës kanë qenë të obliguara të nxjerrin këto draft plane të veprimit për transparencë, ne nuk kemi qenë komuna që kemi bërë një hap të tillë, prandaj na është kërkuar nga ne që në një kohë sa më të shkurtër të mundshme të bëjmë një draft plan të tillë. Për rendësin e draft planit nuk kam çka të flasë sepse para juve e keni edhe rregulloren e cila do të vije për rishqyrtim dhe aprovim. Në KPF janë dhënë disa sugjerime që të bëhen disa intervenime ose përmisime në aspektin e formulimit të fjalive, këto janë përmisuar menjëherë. Kabineti i Kryetarit nuk ka bërë ndonjë veprim të veçantë, vetëm se i ka zbatuar rekomandimet e MAPL-së duke u bazuar gjithmonë në ligj dhe udhëzim administrativ. Është obligative sipas shkresës së MAPL-së që kuvendi ta shqyrtoj dhe në fund ta aprovoj. Ky është dokumenti i parë pas këtij dokumenti pasojnë edhe dy dokumentet të tjera, në këtë mbledhje e ceka është edhe rregullorja mbi qasjen në dokumentet publike, pjesë e kësaj do të jetë edhe strategjia komunale për komunikim e cila do të vije ma vonë.

Rasim Fazliu – Është mirë që e kemi këtë draft planë për transparencë sepse ky draft planë i ofron publikut që të kenë ma shumë informata rreth menaxhimit të përgjithshëm të komunës së Rahovecit. Do të ndalem tek disa pika, aty ku shënon komuna mendoj se kishte me qen më mirë që të specifikohet se kush nga komuna, tek pika 4 shkruan? kuvendi i komunës duhet të shqyrtoj mundësin për të mbajtur takime shtesë që lidhet me buxhetin komunal, dua të ju bëjë të qartë se deri më tani kuvendi i komunës nuk ka mbajtur asnjëherë deri më tani takim me qytetar, pra kërkoj një sqarim rreth kësaj.

Nënkryetari – Desha të rumbullaksoj këtë, po ashtu të krijoj një masë mbrojtëse, ju thash se ne nuk kemi shpik asgjë ky draft plan ka ardhë nga MAPL-ja si formë e gatshme. Diku thuhet Komuna e diku

Kuvendi për arsye se draft plani i veprimit nuk kufizon asgjë sepse në bazë të draft planit jemi të obliguar ta konsultojmë ligjin për transparencë, udhëzimin administrativ, ligjin për vetëqeverisje lokale dhe statutin e komunës, krejt çka parashihet në këto ligje dhe udhëzime duhet të veprohet, kryesuesi, Kuvendi, Kryetari apo komuna është çështje që do zbërthehet ma vonë. Ky është plan që duhet veprohet në mënyrë obligative në periudhat e ardhshme.

Florijs Boshnjaku – Lidhje me këtë Plan të Veprimit edhe në KPF kam diskutuar i kam dhënë propozime dhe disa sugjerime e mija, po ashtu e kam falënderuar shefin e kabinetit të zyrës së kryetarit z. Haziz Krasniqi, Plani i Veprimit që është sjellë në KPF dhe ky sot që na është sjellë në Kuvend ka pak përmisime por nuk është ashtu si duhet, nënkryetari e tha neve kështu na ka ardhë prej Ministrisë ne nuk mundemi këtë Plan të votojmë drejtpërsëdrejti ashtu si na kanë sjellë, pa e lexuar dhe pa i përmisuar gabimet sepse ky është një akt të cilin e ka propozuar Kryetari Komunës së bashku me shefin e kabinetit. Ky Plan i veprimit së pari nuk është i nënshkruar, pastaj duhet të kemi të qartë se cilat janë takimet publike, cilat janë konsultimet publike dhe cilat janë dëgjimet publike, unë i kam dhënë propozimet por shumë pak janë inkorporuar në këtë plan. Tek mbledhja e jashtëzakonshme menjëherë më poshtë e kemi të cekur mbledhje e rregullt, duhet të jetë mbledhje e jashtëzakonshme. Tek diskutimi me publikun dihet se cilat dokumente dalin në diskutim publik. Ne si grup i AAK-së e përkrahim këtë plan më vjen mirë që është bërë ky plan dhe patjetër që duhet të miratohet, por duhet disa gjëra të ndryshohen, nëse pajtohen të gjithë në mënyrë që mos të ju mar kohë këtu unë kisha bisedu me Hazizin dhe i kisha treguar se ku duhet bërë përmisimet.

Nënkryetari – Të gjitha sugjerimet që i keni dhanë ju në KPF, Hazizi dhe Betimi i kanë përmisuar, po ashtu nuk është se të gjitha që i thua ti z. Florijs janë të sakta dhe ashtu duhet të jetë, ti je kuvendare mundë të thuash që të duash por nuk mundesh të më mbushesh mendjen mua sepse edhe unë kam të drejtë e asaj të mendoj ashtu si mendoj unë. Në fillim ju thashë se ky është një plan veprimi dhe nuk sqaron detale të caktuara. Pastaj tek njoftimet, forma e njoftimit të qytetarëve për mbledhjen e jashtëzakonshme është njësoj si njoftimi për mbledhje të rregullt sepse duhet të caktosh edhe rendin e ditës, kohën e mbajtjes, vendin e mbajtjes etj. Pastaj njoftimi për mbledhje të jashtëzakonshme është 3 ditë para datës së mbledhjes, kjo i sqaron të gjitha gjërat e tjera. Ju mundë të jepni vërejtje dhe sugjerime sa të doni këta munden të i bëjnë përmisimet por nuk do të ndikoni asgjë në esencën dhe përmbajtjen e këtij dokumenti.

Kryesuesi – Nëse nuk i sqaron Plani i Veprimit veprimet konkrete atëherë kush duhet ti sqaroj, plani i veprimit sipas meje duhet të jetë konkret dhe udhëzues. Po ashtu mendoj se MAPL-ja që e ka dërguar këtë plan i ka dhënë mundësi edhe kuvendit që të bëjë ndërhyrje në mënyrë që të dele një plan i veprimit konkret dhe funksional. Po ashtu ka qenë mirë që ato vërejtje që i ka dhënë delegatja Florijs të dallohen në këtë plan në mënyrë që sot të dimë se cilat janë përmisuar e cilat nuk janë.

Florijs Boshnjaku – Nënkryetari e ka pas zakon edhe kur ka qenë kryesues me e ngitë zërin dhe aty ku nuk ka të drejtë e ngitë edhe ma shumë zërin në mënyrë që ne të tjerët ta ulim zërin, por kjo kohë mendoj se ka kaluar. Unë nuk jam që dokumentet e komunës të dalin keq or jam që këto dokumentet të dalim ashtu si duhet dhe për këtë arsye ky kuvend është duke debatuar. Po ashtu jam duke dhënë mendimin tim dhe nuk do të thotë se çdo propozim i imi është i saktë, atë më së miri e vlerësojnë kuvendarët me votim.

Hysi Gashi – Desha të ndalem tek pika 9 e këtij draft plani, ku flitet për freskimin e web faqes zyrtare të komunës, disa herë nga kureshtja kam hyrë në web faqe që ti shikoj disa gjëra por përveç rregulloreve dhe vendimeve që publikohen rregullisht gjërat e tjera ka shumë pak. Tek lista e projektet kapitale nuk është postuar asgjë që nga viti 2011, pastaj procesverbalet e mbledhjeve i fundit që është publikuar është i muajit prill 2015 edhe 9 procesverbalet e tjera mungojnë.

Kryetari – Zyratari i Komunës Hysni po thotë se janë të publikuara, ndoshta keni gabuar dhe nuk keni hyrë mirë në web faqe. Po ashtu disa gjëra kohët e fundit nuk janë postuar sepse Dritani ka qenë në tretman mjekësor. Hysni edhe unë nuk jam njohës i mirë i informatikës dhe shpesh herë nuk

mundem mi gjete disa gjëra që më interesojnë por këta djem që janë më të shkathët e kanë më të lehtë. Dhe nëse thua që nga 2011 nuk ka publikime është një gabim i madh, unë nuk jam për me mbrojtje askënd pra duhet të gjitha të postohen në web faqe në afat. Sa i përket Planit të Veprimit ne të gjithë e dimë se çka është plani i veprimit, nëse flasim për mbledhje të rregullta ne të gjithë e dimë se kur mbahen, ndërsa mbledhjet e jashtëzakonshme parashihen me u mbajte por ne nuk e dimë se a do të kemi mbledhje të jashtëzakonshme dhe shpresoj se nuk do të kem asnjëherë, ne duhet të lutemi që mos të kemi mbledhje të jashtëzakonshme se të gjithë e dimë se për çfarë arsye mbahen mbledhjet e jashtëzakonshme. Ne e kemi pas një matricë nga MAPL-ja dhe duhet që ta adaptojmë, komunat në Kosovë gati se të gjithë e kanë një rregullim të njëjtë.

Rukije Krasniqi – A ka implikime buxhetore implementimi i këtij Plani të Veprimit sepse po shoh se duhet të hapen disa zyre p.sh. për marrëdhënie me publikun.

Kryetari – Fillimisht e kemi një numër të caktuar të punëtorëve, rekomandim është që të mbulohen gjitha vendet e punë me stafin që e kemi brenda komunës, nëse ne nuk mundemi atëherë kërkesa dihet se ku shkon për numrin shtesë të punëtorëve. ne kemi intenca që ta shtojmë numrin e punëtorëve të shëndetësisë pas po tentojmë me pas repartin e dializës, a do ta pranojnë kërkesën ton kjo nuk varet prej neve por ne nuk do të heshtim do të kërkojmë.

Kryesuesi – Kam një reagim të përfaqësuesit të OSBE-së, ku thuhet se së pari duhet të ketë një bazë ligjore që të aprovohet rregullorja e pastaj plani i veprimit, është mirë që të lihet një herë Plani i veprimit për arsye se Draft Rregullorja për transparencë që është e paraparë sot të aprovohet duhet të aprovohet në parim në mënyrë që të del në debat publik e pastaj në mbledhjen e radhës të bëhet aprovimi i saj dhe të njëjtën kohë e aprovojme edhe planin e veprimit.

Qazim Qeska- Përsëritet për të gjithë të pranishmit, Kam besim të plotë në kolegët që punojnë në zyrën ligjore të Komunës së Rahovecit. Por sidoqoftë sipas juridiksionin përkatës një herë nxirët Kushtetuta, pas kushtetutës Ligjet, pas ligjeve rregulloret, pas rregullores udhëzimet. Por mbase Betimi është përgjegjës për këtë fushë në kuadër të administratës komunale ne duhet të kemi besim të plotë në punëtorët e zyrës ligjore. Të dy dokumentet kanë të bëjnë me transparencën e administratës komunale dhe që të dyja ne sot duhet ti aprovojme në mënyrë që të dalin në debat publik.

Kryetari - A duhet ti besojmë atë që e lexoj betimi nëse po atëherë sipas betimit një herr duhet Plani i veprimit për transparencë e pastaj rregullorja për transparencë nëse jo atëherë nesër mundet dikush të dele duke u thirrur në këto dy pika dhe të na kontestoj vendimin që do ta marrim.

Rexhep Oruçi – Rregullorja është akt nënligjor dhe ka peshën më të madhe se sa një plan operativ, gjithmonë duhet të bazohemi në një akt juridik më të lartë në mënyrë që të nxjerrim një akt të nivelit më të ulët.

Kryesuesi – E qesë në votim Draft Planin e veprimit për transparencë me vërejtjet të cilët i dhanë delegatët: Konstatohet se në mënyrë unanime është aprovuar Draft Plani i Veprimit për Transparencë i komunës së Rahovecit. Kalojmë në pikën e radhës:

4. Shqyrtimi dhe aprovimi i Draft Rregullores për transparencë,

Kjo pikë e rendit të ditës sot kalon në parim dhe i jepet leje që të del në debat publik dhe pas 30 dite vjen në kuvend për aprovim.

Sali Sallteku – Përsëritet për të gjithë të pranishmit, Drejtoria për administratën të përgjithshme duke u nisur nga kompetencat dhe autorizimet që i ka dhe në bazë të rekomandimeve të Ministrisë dhe OSBE-së, kemi marr iniciativën për draftimin të rregullores për transparencë. Rregullorja e deritanishme ishte miratuar nga kuvendi komunës së Rahovecit 02 Prill 2013, ndërsa me 12.07.2013 është nxjerrë udhëzimi administrativ Nr.05/2013 dhe rregullorja e deritanishme është në kundërshtim me një seri nenesh. Prandaj duke u bazuar në ligjin për vetëqeverisje lokale, ligjin për qasje në dokumentet publike, në rregulloren për evidencat e zyrtarit të kërkesave për qasje në dokumente publike, rregullorja për tarifa për qasje në dokumente publike, udhëzimi administrativ për transparencë në komuna i hartuar nga MAPL-ja të datës 12.07.2013. Rregullorja që ju sot e keni para vetës është në harmoni të plotë me

dispozitat ligjore të akteve të lartcekura. Ky draft përmban në vete pjesët: Qëllimin, fushëveprimin, përkufizimet, mbledhjet e kuvendit komunal dhe komitetet, publikimet e akteve të komunës, kërkesat për informim iniciativa qytetare dhe petitionet, takime me publikun, konsultimi me publikun para miratimit të akteve komunale, qasje në dokumente zyrtare të komunës, tarifat për posedim të kopjeve fizike të dokumenteve zyrtare, dispozitat kalimtare dhe përfundimtare, pra të gjitha këto janë të përfshira në këtë rregullore për transparencë. I mirëpres çdo koment dhe çdo sugjerim tuajin.

Florije Boshnjaku - Ne këtë rregullore e kemi shqyrtuar edhe në KPF dhe aty i kemi dhënë vërejtjet sugjerimet dhe propozimet, por sot jam duke parë se asnjë ndryshim nuk është bërë. Ne në parim jemi që kjo rregullore të kalojë por nëse nuk përmissohen si do ta qesim në diskutim publik.

Betim Behluli – Përshëndetje për të gjithë të pranishmit, pavarësisht se si mendoj unë apo dikush tjetër ne jemi munduar që edhe tërmet mos të ja ndryshojmë udhëzimit administrativ, ne si zyre ligjore nuk kemi pas guxim ti ndërrojmë tërmet e nëse ju keni guxim ndërrojeni. Të gjitha vërejtjet që janë dhënë në KPF ne në një takim të përbashkët me Drejtorin e administratës dhe Nënkryetarin jemi munduar që ti inkorporojmë, por ja që gjitha propozimet janë në kundërshtim me udhëzimin administrativ, përpos termit detyrimisht që ka qenë e kemi ndryshuar e kemi bërë obligim, po ashtu e kemi bërë përmasimin e një gabimi teknik që është bërë tek hyrja në fuqi e rregullores.

Kryetari – Ligjet dhe udhëzimet administrative që janë aktet nënligjore janë obliguese, po ashtu edhe rregulloret por së pari këto dy të parët që i përmenda. Këto dokumente kur përgatitet teksti nuk guxon me deviju nga lista e përkufizimeve, pra duhet të jetë ose tubim ose takim e jo diku tubim e diku takim ose mbledhje ose konsultë, pra duhet të gjendet vendi se ku duhet të jetë tubim e ku takim. Secili dokument kur shkruhet për herr të parë duhet të shikohet disa herë dhe sa herë që e lexon e sheh se ku ka bërë lëshim dhe e bënë përmasimin.

Rasim Fazliu - Kryesues le të jetë kjo hera e fundit që qitet në aprovim shkel e shko, edhe pikën para kësaj që e kaluam kaloj shpejt e shpejtë sikurse po ngutemi, zonja dhe zotërit që njihen me këtë lami dëshirojnë të japin kontributin që tërmet të ceken aty ku duhet. Pra le të jepet kontribut i kuvendit e pastaj le të del në debat publik që edhe qytetarët të japin kontributin e vet e pastaj le të kthehet në kuvend për tu aprovuar.

Kryesuesi - I kisha lutë këshilltarët ata që kanë përvojë juridike që në të ardhmen të gjitha këto që janë duke i than me gojë të i bëjnë me shkrim dhe ti deponojnë këtu dhe pasi ti lexojnë bëhen pjesë e dokumentit. E qesë në aprovim në parim pikën e 4 të rendit të ditës dhe këto vërejtje që i dhanë këshilltarët duhet të përmissohen dhe të inkorporohen në rregullore. Kjo rregullore do të shkojë për debat publik e pas 30 ditëve do të vijë në kuvend për aprovim. Konstatoj se në mënyrë unanime është aprovuar rregullorja për transparencë dhe i jepet leje që të del në debat publik për 30 ditë e pastaj të kthehet në kuvend për aprovim. Kalojmë në pikën e radhës:

5. Shqyrtimi dhe aprovimi i Draft Rregullores për dhënien e lejeve mjedisore komunale,

Fitnete Iska – Përshëndetje për të gjithë të pranishmit, kam kënaqësi që para juve sot të prezantoj draft rregulloren e re për dhënien e lejeve mjedisore komunale. me hyrjen në fuqi të Udhëzimit Administrativ për dhënien e Lejeve Mjedisore komunale, Nr 17/2015 të datës 01.12.2015 Drejtoria për Urbanizëm Planifikim dhe Mbrojtje të Mjedisit në bashkëpunim me Zyrën ligjore kanë konsideruar të arsyeshme hartimin e rregullores së re sepse është paraqitur nevoja e ndryshimeve të shumta, të dispozitave të rregullores së vjetër. Pas hyrjes në fuqi të Udhëzimit Administrativ të sponsorizuar na MPH ka qenë e nevojshme të intervenohet në gjithsej 16 dispozita përfshirë edhe shtojcën, listën e aktiviteteve që i nënshtrohen lejes mjedisore komunale. Siç e dini qëllimi i kësaj rregullore është parandalimi ose zvogëlimi i ndikimit negativ në mjedis të shkaktuar nga subjektet publike dhe private me rastin e realizimit të veprimeve dhe projekteve përkatëse të cilat mund të shkaktojnë çrregullime në mjedis. Rregullorja ka gjithsej 27 nene dhe me hyrjen në fuqi të kësaj Rregullore shfuqizohet rregullorja e vjetër nr. 2408 të datës 30.06.2015. ndryshimet dhe intervenimet janë bërë në këto dispozita: Në pjesën hyrëse – neni 58 pika (h) të ligjit për vetëqeverisje lokale nr. 03/L-040, neni 2- te përkufizimet, neni 4 –

aplikimi për LMK, neni 5 – paraqitja e kërkesës, neni 7 – përpilimi i raportit për marrjen e LMK-së, neni 8 – komisioni profesional për vlerësimin e raportit të ndikimit në mjedis, neni 9 – afati për miratimin aktvendimi për LMK nënshkruhet nga Drejtori i Urbanizmit, neni 10 – tarifa, neni 12 – E drejta e ankesës, aplikuesi ka të drejtë të ushtroj ankesë në komunë në drejtorin për urbanizëm, planifikim dhe mbrojtje të mjedisit, neni 13 – transferim e LMK-së, neni 14 - ndërprerja e vlefshmërisë së vendimit të LMK, neni 16 – regjistri i lejes mjedisore komunale, neni 17 – dispozitat ndëshkuese, neni 18, 19,20 – dispozitat përfundimtare. Dispozita e paraparë tek neni 9 pika 3 afati i lëshimeve të lejeve mjedisore duhet të hiqet nga kjo rregullore sepse komuna më nuk është kompetente por Ministria kështu na ka ardhur një rekomandim nga Ministria të cilën e kemi marrë para disa ditëve Draft rregullorja për dhënien e lejes mjedisore komunale do të hyjë në fuqi 14 ditë pas debatit publik dhe pas votimit nga kuvendi. Presim nga ju që ti parashtoni vërejtjet dhe sugjerimet tuaja.

Kryesuesi – Po ashtu edhe kjo rregullore i ka procedurat e njëjta si rregullorja paraprake, pas kalimit në parim sot del në debat publikë për 30 ditë dhe prapë do të kthehet në kuvend për aprovim final.

Flori Boshnjaku – Më vije keq që jam duke dhënë këto vërejtje por nuk ka përmisime, ana teknike dhe ana profesionale nuk është duke u përmisuar, më duket edhe kur hynë në fuqi këto rregullore mbesin kështu si janë nuk përmisohen. Qysh në fillim shkruan Kryetari i Komunës është sponsorizues i kësaj draft rregullore, gabimi tjetër Rahovec 2015, në funde të rregullores shkruan Kryesuesi nuk ka kurrfarë emri, tash nuk jemi duke ditë a është propozues i kësaj rregullore Kryesuesi apo Kryetari, nëse në fillim është kryetari atëherë edhe në fund duhet të jetë ashtu, nuk mundet të dytë të jenë sponsorizues të një rregullore. Tek neni 8 afati për miratim, a duhet të jetë afati për miratim apo afati për shqyrtim. Pastaj brenda afatit prej 30 ditësh nga dita e pranimit të kërkesës me raporte të LMK-së dhe në bazë të vlerësimit për miratim dhe refuzim nga komisioni profesional, zyrtarja e mjedisit harton miratimin ose refuzimin e për leje të LMK-së dhe akti nënshkruhet nga drejtori. Dua të di se cila është puna e komisionit që e formon drejtori, kush i propozon drejtorit komisioni apo zyrtarja e mjedisit. Tek anëtarët e komisionit që i cakton propozoj që të jenë 2 anëtar të përhershëm dhe 1 varësisht prej rastit.

Rukije Krasniqi – Kam një vërejtje për këshilltarët e pozitës, mos të thuhet se këto janë kritika vetëm nga opozita por duhet të japin kritika edhe profesionistët nga pozita, pra mos të jetë vetëm barë e opozitës dhe të shihet si këndvështrim kritik.

Kryesuesi – Kontributi është i gjithëve dikush jepe kontribut më shumë dikush më pak në çështje të caktuara profesionale, në çështje juridike nuk mundet të jepe kontribute njohësi i gjuhës shqipe.

Selim Duraku – Tek dispozitat ndëshkuese neni 18 kundërvajtjet, nga 2.500 € - 5.000 € gjobiten personat juridik ose fizik të cilët nuk raportojnë në LMK, kurse tek neni 19 gjobiten me 250 € ata të cilët nuk kanë LMK fare. Pra ma mirë të bie mos me e regjistru se sa me regjistru.

Ilir Haxhijaha – Përsëendetje për gjithë të pranishmit, sa i përket vërejtjes që u dha tek neni 19 është për ata persona fizik dhe juridik që kanë aplikuar për leje, pra kanë zhvilluar procedurën por për faj të tyre nuk janë pajisur me leje të LMK-së. Tek kompetenca e komisionit profesional, ky komision emërohet nga drejtori, ky komision del në vendngjarje harton një procesverbal dhe konstaton gjendjen faktike se a i plotëson kriteret apo jo e pastaj ja prezantojnë drejtorit për lëshim.

Kryesuesi – E qes në votim në parim Rregulloren për dhënien e lejeve mjedisore komunale e cila do të del në debat publik në afat prej 30 dite e pastaj do të vije për aprovim final në kuvend: Konstatohet se në mënyrë unanime është aprovuar në parim Rregullorja për dhënien e lejeve mjedisore komunale.

6. Rishqyrtimi i Vendimit të Kuvendit të Komunës së Rahovecit 01 Nr. 223/15 të datës 09.12.2015, Këtu kemi të bëjmë me shqyrtimin e një vendimi të kuvendit komunal 01 Nr.223/15 të datës 09.12.2015, ky vendim është kthyer nga MAPL-ja, për shkak të disa lëshimeve që janë bërë, se ku ka pas lëshime për këtë ja jap fjalën drejtorit.

Kujtim Popaj – Përsëendetje për të gjithë të pranishmit, kjo pikë është vendosur në shqyrtim në bazë të kërkesës së MAPL-së e cila ka të bëjë me shqyrtimin e vendimit të kuvendit të datës 09.12.2015. kjo Ministri ka gjete parregullsi në vendimin e shpalljes së interesit të përgjithshëm për parcelat që janë në

pronë të komunës, tani ne e kemi hartuar vendimin e ri dhe është bërë revidimi i vendimit të kaluar, ne e kemi ndryshuar këtë vendim dhe kemi bërë thirrje vetëm në ligjin e vetëqeverisjes lokale ku kemi menduar që këto parcela të i shpallim interes të përgjithshëm por duke mos e specifikuar afatin, qoftë afatshkurtër ose afatgjatë. Pasi që janë parcelat e ndara në të ardhmen me një vendim tjetër do të përcaktohem se a do ti japim në shfrytëzim me afat shkurt apo afat mesëm.

Kryesuesi – E qes në votim pikën e 6 të rendit të ditës: Konstatohet se në mënyrë unanime është aprovuar pika e 6 e rendit të ditës. Kalojmë në pikën e radhës:

7. Shqyrtimi i Raportit për punët inspektuese për periudhën Janar – Dhjetor 2015,

Edhe kjo pikë e rendit të ditës është shqyrtuar në mbledhjen e KPF – së, nëse ka diçka shtesë drejtori të cek që nuk e ka thanë në KPF mundë të del të na prezantoj, nëse jo vazhdojmë me diskutime.

Rasim Fazliu – Falënderoj fillimisht drejtorin që na ka ofruar raportin vjetor të punës për vitin 2015. Dua të ndalem tek inspektori sanitar ku thuhet se me urdhëresë të agjensionit të ushqimit dhe veterinarisë nga tregu është larguar qumështi Aptamil si qumësht i dyshuar për përdorim, dua të di se çka është bërë me atë qumësht ku është dërguar. Po ashtu edhe inspektorët e mjedisit ka zhvilluar një aksion të përbashkët me inspektorët e MPH konkrëtisht me inspektorët e minierave dhe mineraleve ku janë inspektuar disa zona të mbrojtura në komunën tonë. Është bërë mirë që është bërë ky aksion por nuk ndonjë të dhënë se çka është arritur me këtë aksion. Kam edhe një pyetje për drejtorin në lidhje me vendosjen e policëve të shtrirë nëpër rrugë sipas dëshirës së qytetareve pa e pyetur askënd, dua ta di se a ka ndërmarr diçka drejtori në bashkëpunim me drejtorët e tjerë në lidhje me këtë problem.

Afrim Limani – Jam kureshtar të di pse doli vetëm raporti i drejtorisë së inspektoratit, më duket si i pakuptimtë. Më mirë kishte me qenë të kishte dalë raporti për gjitha drejtoritë të komunës së Rahovecit. Raporti si raporte për mendimin time është shumë i kompletuar, kam një pyetje konkrete për drejtorin? Te faqja Nr. 2 tek mbrojtja e lumenjve a është bërë ndonjë veprim brenda vitit 2015 për mbrojtjen e lumenjve. Gjithashtu ajo që më ka lënë ma shumë përshtypje është faqja e fundit ku drejtori i ka raportuar edhe shpenzimet e karburanteve të veturave. Po ashtu kam një vërejtje për drejtorin se pse nuk i ka raportuar edhe realizimin e të hyrave të kësaj drejtorie duke e ditur se kjo drejtori është një katalizator i madh i cili reflekton indirekt edhe në realizimin e drejtorive tjera.

Kryesuesi – Gatë një punëtorie që e kemi pas me DEMOSIN në Prevallë është kërkuar nga drejtori që të ketë një raporte në fund të vitit, ne nuk kemi mundur ta fusim në fund vite për atë arsye e kemi futur në këtë mbledhje.

Rukije Krasniqi – Kam një pyetje për drejtorin? Tek inspektorët sanitar thuhet: Ka inspektuar largimin dhe asgjësimin e artikujve ushqimor në sasi prej 12.368 kg pemë perime dhe vezë, këto janë konsume pothuajse të përditshme ushqimore, kur flasim për pemë dhe perime ato të këqija i mënjanojmë vetë, por çka bëhet me vezë sepse ato nuk i dimë a janë me afat apo pa afat, për këtë arsye dua ta di nga drejtori se vezët e punës a janë larguar sepse kanë qenë pa afat apo nga ndonjë konkluzion nga ndonjë analizë të veterinarit për arsye të ndonjë virusi.

Hysni Gashi – A është diskutuar ose inspektuar ndonjë herë për objektet që janë ndërtuar në prona të huaja dhe në prona publike.

Muhamet Behra – I falënderoj delegatët për pyetjet e parashtruara. Po ja filloj me pyetjen e delegatit Rasim Fazliut. Nga dyshimet që kanë ardhur për qumështin Aptamil inspektorët sanitar në bashkëpunim me agjensionin e ushqimit dhe veterinarisë e kanë larguar nga shitja për një afat të caktuar deri sa kanë ardhur analizat për përbërjen e qumështit nuk e kanë asgjësuar dhe mbase kanë ardhur analizat qumështi Aptamil është kthyer për shitje dhe konsum. Sa i përket zonës së mjedisit kemi të bëjmë me një raste në zonën e mbrojtjeve të monumenteve natyrore tek zona e Gradishit, ku një pronar privat e ka blerë një patundshmëri dhe ka filluar të bëjë insplatin e gurëve dhe në këtë kuadër ne kemi ftuar inspektorët e minierave dhe mineralëve ku është në përgjegjësinë e tyre si kompetencë dhe që një vite ju është ndërprerë puna. Sa i përket pengesave në rrugë ne për çdo ditë i hasim, këtu kemi dy grupe të njerëzve disa kërkojnë që ti qesim pengesat në rrugë disa tjerë kërkojnë që të hiqen këto pengesa, ne jemi

pjesëmarrës në komisione së bashku me drejtorin e shërbimeve publike pikërisht për këtë problematik. Para se të vijmë ne në pushtet në rrugën Retij dhe Zoqishtë janë vendosur pengesat pa kritere ku kanë dashtë banorët i kanë vendos, ndërsa pasi kemi ardh ne në pushtet çdo pengesë që është vendosur është vendosur në bazë kritereve që e ka paraparë Komisioni. Afrim ligji për mbrojtjen e lumenjve dhe mjedisit implementohet më shumë nga inspektorët e Ministrisë së mjedisit, ne si komunë vetëm kemi asistuar në inspektim. Të hyrat vetanake Afrim janë të publikuara në tabelën e raportit, aty janë të hyrat nga kërkesat e qytetareve që kanë bërë për dalje të inspektimit në teren, janë të hyrat nga gjobat mandatorë, të hyrat nga drejtoria për punë inspektuese janë afro 13.000 €. Rukije zakonisht largimi i artikujve ushqimor përveç që e largojmë kur i skadon afati, por shumica e të dhënave që i keni në raporte janë nga këto qendra të mëdha që i kemi në komunën tonë, ata bëjnë kërkesë në mënyrë vullnetare për asgjësim të produkteve. Sa i përket vezëve ato janë asgjësuar për shkak të afatit. Hysniu pyeti për sektorin e ndërtimit, kemi shumë raste shumica janë të evidentuara të cilët kanë ndërtuar objekte në prona publike, inspektorët e ndërtimit kur hasin menjëherë fillon procedura ndaj këtyre shkelësve. Ne si drejtori nuk mundemi të evidentojmë ne e iniciojmë rastin tek shërbimi pronësor juridik tek drejtoria e gjeodezisë dhe kadastrës dhe pasi të vije vendimi nga drejtoria për gjeodezi dhe kadastrë ne e ndërpresim ndërtimin.

Kryesuesi – Falënderoj drejtorin për gatishmërinë që e ka pas për me e raportu para delegatëve të kuvendit të komunës. Kalojmë në pikën e radhës:

8. Shqyrtimi i kërkesës së N:T:H “Mowenpick” nga Rahoveci,

Këtë pikë do e shqyrtojmë në mbledhjen e ardhshme për arsye se drejtori nuk është këtu që ta prezantoj.

9. Shqyrtimi i kërkesës së Razije Kryeziu nga Rahoveci,

Edhe kjo kërkesë është shqyrtuar në KPF, këtu kemi të bëjmë me pronat të cilat komuna i ka dhënë në shfrytëzim në vitin 2002 për 10 vite, këtu janë diku 33 troje nga këto 33 afër 10 shtëpi janë ndërtuar. Problemi qëndron se këtyre i ka skaduar kontrata dhe këto prona janë pronë komunale por shfrytëzues është ekonomia e pyjeve, po ashtu ligji më nuk e parasheh që komuna ti jepe këto prona me afatgjatë pa konkurs, ne nuk kemi zgjidhje tjetër pos të i lëmë kështu si janë deri sa konsultohemi lartë me nivelin qendror. Ne drejtorin e kemi autorizuar që të bisedoj me Ministrinë përgjegjëse.

Kujtim Popaj – Gjendja qëndron ashtu si e ceku kryesuesi, Kuvendi i komunës në vitin 2001 ka marrë një vendim ku ka ndarë një pjesë të parcelës 2240/1 që është me një sipërfaqe 770 hektar, prej kësaj sipërfaqe është ndarë një parcelë prej 1 hektar e gjysmë për dhënie të trojeve për familje me raste sociale. Mua më vije keq për këtë kërkesë që e ka bërë zonja por në kohën kur është bërë parcelimi i këtyre parcelave dhe ju është dhënë në shfrytëzim për periudhën 10 vjeçare kuvendi i komunës ka punuar me rregulloren 2000/45 dhe me statutin që e ka pas në fuqi në atë kohë. Ligji tani është ndryshuar ku e ka anuluar këtë pjesë, tani me ligjin e ri në asnjë akt nuk caktohet se duhet të veprohet me këto kategori. Ne kemi mbetur në një pozitë ku nuk e dimë se si të veprojmë edhe me rastet e tjera që kanë të njëjtin problem si z. Razije. Në listë poseduese ceket se është pronë komunale por shfrytëzues është prona e pyjeve, kryesuesi e tha se duhet që drejtoria ime të mirët me këtë problem, kishte me qen mirë që edhe në emër të kryesuesit të kërkohet një shpjegim nga ana e MAPL-së se si të veprojmë.

Fatmir Iska – Mendoj se nuk kemi çka të bisedojmë rreth kësaj kërkesë, është mirë që drejtori të mirët me këtë problem mbase kur janë dhënë këto prona kanë qenë në fuqi ligjet tjera në fuqi, ndërsa tani kemi një situatë komplet tjetër. Është mirë që drejtori të kontaktoj me agjensionin e pyjeve të Kosovës që të gjendet një mundësi për tu kryer kjo punë, ata që i kanë shtëpitë në këto troje të i vazhdohet afati ndërsa ata që nuk kanë ndërtuar asgjë në këto troje të i rikthehen këto troje kuvendit komunal.

Rasim Fazliu – Së pari më vije keq sepse ky është një rast social, kjo zonjë me 18.01.2011 e ka bërë një kërkesë dhe nuk është shqyrtuar fare, është dashur atëherë të mirët parasysh kjo kërkesë dhe ndoshta kishe përfunduar kjo punë sepse siç e tha drejtori në atë kohë kanë qenë në fuqi ligjet e tjera.

Kryesuesi – Kjo kërkesë edhe në përbërjen e kuvendit të kaluar është trajtuar por është refuzuar për arsye të njëjta që i kemi edhe sot.

Qazim Qeska – Rasti është pak problematik por ne duhet ti ndihmojmë sepse do të kemi edhe raste të tjera të ngjashme në të ardhmen, deri sa isha në pozitën e zëvendësministrit komuna ka pas nevojë për një palujtshëmëri për nevojat e veta që ishte nën juridiksionin e Ministrisë së Bujqësisë në rastin e ndërtimit të ambulantes, po ashtu edhe në këtë rast duhet të kërkojmë nga Ministria e Bujqësisë, agjensionit Kosovar të pyjeve që është në kuadër të kësaj ministrie që ti bartë nën administrim të Kuvendit komunal.

Kryesuesi – E qes në votim pikën e 9 të rendit të ditës me arsyen se kjo kërkesë refuzohet për arsye se është pronë e komunës por shfrytëzues është agjensioni i pyjeve dhe prona e shfrytëzimit të pronave komunale jepet sipas ligjeve që janë në fuqi, me një rekomandim që drejtori me kryesuesin të kontaktojnë me nivelin qendror për të gjetur një zgjidhje për të ardhmen: Konstatohet se me 2 abstenime dhe të tjerët pro është refuzuar pika e 9 me arsyetimet që i cekëm më lartë. Pika e radhës është:

10. Pyetjet dhe përgjigjet në pyetjen e këshilltarëve.

Fatmir Iska – Kam lexuar dhe parë nëpër rrjetet sociale ku e kanë prezantuar një shtëpi të vjetër të pa banuar tek kthesa e Mullalieve që paraqet një rrezik për qytetarët, unë duku verës e kam ngritë këtë shqetësim dhe kam propozuar edhe tash prapë po propozoj që Kryetari i Komunës së bashku me ekipin e tij përgjegjës të formoj një komision dhe ti evidentoj të gjitha këto objekte që paraqesin rrezik permanent për qytetarët dhe të merren masa dhe të mirëtohet një vendim për evitimin e këtyre rreziqeve.

Florije Boshnjaku – Ku ka mbete çështja e stacionit të autobusëve.

Selim Duraku – Dua të di a është formuar ndonjë komision për të vlerësuar vërshimet e fundit që kanë ndodhur nga rrënja shiu sepse ka pas dëme të mjaftueshme në tokat bujqësore të Krushës së Madhe ku janë dëmtuar mbi 6 hektar qepë dhe mbi 10 hektar tokë që është e pa punueshme. E gjitha kjo ka ardhë si pasojë e asaj proceje që kalon në mes fshatit Krushe e Madhe dhe Celin ku unë e kam ngritë si çështje së paku 16 herë. Pyetje tjetër është për kapakët e kanalizimit të cilët dalim mbi 30cm mbi asfalt dhe nuk e zgjidhin ndonjë problem.

Rukije Krasniqi – Dua të di se kur do të filloj punën shkolla e re Isa Boletini sepse kemi pyetje nga nxënës dhe prindërit e tyre.

Afrim Limani – Në seancën e tetorit të vitit të kaluar i kam parashtruar 2 pyetje për drejtorin e shërbimeve publike dhe akoma nuk kam marrë përgjigje, prapë sot do i parashtroj të njëjtat pyetje? pyetja e parë është pse nuk është asfaltuar ose kukëzuar një rrugë në fshatin Dobidol. Pyetje tjetër është a kam të drejtë unë si delegat i kuvendit me e pas një kopje të kontratës që është lidhë në mes drejtorisë së shërbimeve publike dhe K.R.U Radoniqin rreth ofrimit të shërbimeve të kanalizimit.

Besnik Hoti – Pyetja ime është për drejtorin e shërbimeve publike, në fillim të këtij muaji nga erërat e forta ndriçimi publik në fshatin e Ratkocit është dëmtuar dhe personalisht e kam marrë drejtorin në telefon dhe më ka premtuar se do ti rregullojnë ato dëmtime, por ashe nuk është bërë në këtë drejtim ende dua të di pse dhe kur do të vinë për ti rregulluar.

Mbledhja e kuvendit ka përfunduar në ora 13:15.

K R Y E S U E S

Nahit Elshani